

VENDIM
Nr.16, datë 12.1.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
KALIMASH – MORINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash – Morinë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen prej 7 425 (shtatë mijë e katërqind e njëzet e pesë) m² tokë arë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 1 584 424 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet e katër) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 231 500 (dyqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 584 424 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet e katër) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.1.2011 dhe të përfundojë më 15.5.2011.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme të Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, sipas pikës 7 të këtij vendimi.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të shtetit. Kjo procedurë do të ndiqet jo vetëm për këtë vendim, por për të gjitha vendimet e Këshillit të Ministrave që kanë miratuar shpronësimin e pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash – Morinë.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kukës, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pronarët e pasurive të shpronësuar deri në çastin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kukës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSME E RRUGËVE

DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
KALIMASH-MORINË

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K	Nr.pas.	Tokë arë			Vendndodhja	Shënime
						Sip. m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë		
1	Fidaim	Ali	Dida	1176	110/34	897	224	200928	BREG -LUMË	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Halil	Ali	Dida	1176	110/11	1268	224	284032	BREG -LUMË	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3	Haki	Xheladin	Matmuja	1176	247/8	3368	224	754432	BREG -LUMË	Konfirmuar nga ZRPP-ja
4	Maksut	Vehap	Matmuja	2912	97/43	688	190	130720	PERBREG	Konfirmuar nga ZRPP-ja
5	Hamit	Rexhep	Taçi+BP	1726	40/9	1204	178	214312	GJEGJAN	Konfirmuar nga ZRPP-ja
		Totali				7425		1584424		